

DPS	
Nr 36	Dos 2
Di. 09.02.2022	Vt.

Nr. 36 prot
dt. 09.02.22
D. 2

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

NDËRMJET

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË STANDARDIZIMIT

DHE

INSTITUTIT TË NDËRTIMIT

Bazuar në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, hartohet ky Memorandum Mirëkuptimi për Bashkëpunimin ndërmjet palëve të mëposhtme:

- Drejtoria e Përgjithëshme e Standardizimit (DPS), person juridik, publik në varësi të ministrit përgjegjës për ekonominë, përfaqësuar nga z. Riza Hasanaj, Drejtor i Përgjithshëm i DPS, me adresë: Rruga "Reshit Çollaku" (pranë ILDKPI, kati VI), kutia postare 9, Tiranë,

dhe

- Institutit të Ndërtimit (IN), person juridik në varësi të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), përfaqësuar nga z. Artan Shkreli, Drejtor i Përgjithshëm i IN, me adresë: Rruga "Myslym Keta", Brar, Tufinë, Tiranë.

Të dyja palët në përputhje me misionet e tyre dhe të drejtat ligjore përkatëse, kanë rënë dakord të bashkëpunojnë me mirëkuptim në lidhje me sa vijon.

Palët në këtë marrëveshje bien dakord të punojnë në partneritet, për arritjen e objektivave të përbashkëta, në plotësim të qëllimeve dhe objektivave të tyre.

Me vullnet të lirë e të plotë, palët e mësipërme ranë dakord për hartimin dhe nënshkrimin e këtij Memorandumi, sipas kushteve të mëposhtme:

1. OBJEKTI DHE QËLLIMI

1.1 Objekti i këtij Memorandumi Mirëkuptimi është rritja në vazhdimësi e rolit të IN në përbushjen e kërkesave specifike gjatë procesit të integritit evropian, në sektorin e ndërtimit, në përputhje me politikat e Qeverisë, dhe bashkëpunimi ndërinstitucional DPS-IN për ndërgjegjësimin dhe përditësimin e palëve të interesuara me njohuritë dhe praktikat e duhura për implementimin e standardeve të referuara në aktet nënligjore vendase, të cilat janë transpozime të direktivave dhe rregulloreve europiane në këtë fushë.

1.2 Ky Memorandum Mirëkuptimi ka për qëllim rritjen e angazhimit të palëve për një bashkëpunim më të ngushtë midis tyre në fushat respektive.

2. FUSHAT E BASHKËPUNIMIT

Palët me mirëkuptim do të:

2.1 shkëmbejnë rregullisht informacione, që kanë lidhje me fushat e aktiviteteve respektive të DPS dhe IN.

2.2 organizojnë inisiativa promociionale lidhur me standardet në fushën e ndërtimit.

2.3 organizojnë dhe marrin pjesë në konferenca, seminare, kurse trajnimi dhe specializimi, në fushën e ndërtimit.

2.4 bashkëpunojnë për procesin e implementimit të Eurokodeve të Ndërtimit në Shqipëri, në përmbushje të kërkesave të legjislacionit të harmonizuar vendas dhe të Bashkimit Europian, me qëllim ndërgjegjësimin, informimin dhe trajnimin e profesionistëve dhe palëve të interesuara në sektorin e ndërtimit në bashkëpunim me organizma kompetente vendase dhe të huaja, në mënyrë që dokumentat e lëshuara të njihen nga organizmat kompetente europiane dhe vendase, dhe procesi të këtë vlefshmëri në kuadër të levizjes së lirë të profesionistëve në tregun europian, pjesë e së cilës pritet të jetë Shqipëria.

2.5 informojnë njëra tjetrën për mundësitë dhe ofertat për bashkëpunimin në interes të publikut.

Gjithashtu,

2.6 IN do të kontribojë, në përputhje me rregulloret dhe procedurat e DPS, në pjesëmarrjet në Komitetet Teknike të DPS.

3. MËNYRAT E BASHKËPUNIMIT

3.1 Bashkëpunimi do të fokusohet në prioritetet e zbatimit të politikave respektive të ministrive përkatëse nga të cilat varen DPS dhe IN.

3.2 Shkëmbimi i informacionit do të kryhet duke patur parasysh rregullat dhe statusin për përdorimin e informacionit konfidencial, informacionit zyrtar dhe informacionit publik.

3.3 Për çdo mundësi bashkëpunimi, palët do të ofrojnë propozimet respektive me rekomandimet për mënyrat dhe burimet e realizimit.

3.4 Për çdo dakordësim propozim bashkëpunimi, palët do të hartojnë marreveshje specifike.

4. DISPOZITAT E FUNDIT

4.1 Ky Memorandum Mirëkuptimi do të hyjë në zbatim pas nënshkrimit nga titullarët e DPS dhe IN.

4.2 Ky Memorandum Mirëkuptimi nuk kufizohet për periudhë kohore të vlefshmërisë.

4.3 Palët në çdo kohë mund të bëjnë propozime për shtimin dhe/ose ndryshimin e saj, brenda kontekstit dhe fushës së kompetencës së secilës palë në këtë Memorandum.

4.4 Ky Memorandum Mirëkuptimi hartohet në dy kopje në gjuhën shqipe dhe në dy kopje në gjuhën anglisht dhe secila palë merr në momentin e nënshkrimit nga një kopje respektive.

4.5 Ky Memorandum Mirëkuptimi protokollohet në institucionet respektive sipas rregullave ne fuqi dhe mund të vendoset ne faqet e internetit respektive.

Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit



Datë 09.02. 2024

Nr. 36 Prot

Instituti i Ndërtimit



Datë

Nr. Prot

Konceptoi:

K.Dedja

D..SP

Konceptoi;

S.Prendi

I.N/